



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.108/2024
Datë: 23 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 6 të Rregullores Nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, në takimin 325, të mbajtur me datë 23 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, këtë përbërje:
 1. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme / kryetar i komisionit;
 2. Bujar Muzaqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/ anëtar i komisionit;
 3. Sabit Sadikaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtar i komisionit;
 4. Mehmet Ndrecaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/ anëtar rezervë i komisionit;
 5. Lirije Maksutaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtare rezervë e komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 23 prill 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.106/2024, ka shpallur konkurs për rekrutimin e dymbëdhjetë (12) pozitave të lira për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, si dhe ka themeluar Komisionin për Rekrutim.

Me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi në rast të ankesave eventuale të kandidatëve për bashkëpunëtorë profesional ndaj vendimeve të Komisionit për Rekrutim, në këtë takim ka themeluar edhe Komisionin për Rishqyrtim konform nenit 6 të Rregullores Nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Njësisë për Inspektim Gjyqësor;
- Sekretariatit të KGJK-së dhe
- Arkivit.